# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437811**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Marshi për Liri” në Prishtinë, qytetarët mblidhen në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/marshi-per-liri-ne-prishtine-qytetaret-mblidhen-ne-mbeshtetje-te-ish-krereve-te-uck-se/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 06:57:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 06:53:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4ab20f091bba98293d580db6ed60de3d90b9a27acadca7a00cb2b5fb8276c64d` |
| TEKSTI | `9b98f2d237cd134d5e6b20369d88f11240b428f80f0e04d516978ffd38dea033` |
| PAMJA | `d43a0a85e37fb7656dd8990a288ed97b488f100a6a6b86ed91b146687be6638d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `12ffc2108f95c9bd7e09809786ea08b37fd65228cc170fc65f5517bb4367d254` |
| E MËPARSHMJA | `1f7597416ec1e323d0d91fd530b85e0c5426d774e3fa25a8c80a95fb4316ab88` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/12ffc2108f95c9bd7e09809786ea08b37fd65228cc170fc65f5517bb4367d254`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Sot në Prishtinë do të zhvillohet "Marshi për Liri", një tubim në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë.

Marshi do të nisë në orën 14:00 në sheshin "Skënderbeu", ndërsa organizatorët, përmes platformës "Liria Ka Emër", kanë bërë thirrje për pjesëmarrje sa më të gjerë të qytetarëve, në prag të shpalljes së aktgjykimit nga Gjykata Speciale, e parashikuar për 16 shtator.

Programi dhe folësit e aktivitetit janë prezantuar nga Eliza Hoxha. Në pjesën zyrtare të tubimit pritet të ketë fjalime nga përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, familjeve të dëshmorëve dhe figurave politike.

Në emër të shoqatave të dalë nga lufta do të flasë Hysni Gucati, ndërsa Liriona Sulejmani, vajza e dëshmorit Bajram Sulejmani, do të përcjellë mesazhin e familjeve të dëshmorëve dhe brezit që ka trashëguar kujtesën e luftës.

Në mesin e folësve do të jenë edhe Ardian Gjini dhe Bedri Hamza, ndërsa qytetarëve do t'u drejtohet gjithashtu Buna Mustafa, vajza e Salih Mustafës, i njohur me nofkën "Cali".

Tubimi do të shoqërohet edhe me këngë patriotike, të cilat organizatorët i kanë konsideruar pjesë të mesazhit të aktivitetit.

Marshi zhvillohet në kuadër të një sërë aktivitetesh të organizuara në prag të vendimit të Gjykatës Speciale. Një ditë më parë ka përfunduar aktiviteti

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor! Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

"7 Zjarret në 7 Zonat Operative të UÇK-së".

Ndërkohë, më 15 dhe 16 shtator pritet të zhvillohet edhe "Nata e Pritjes" në Hagë. Rreth 50 veteranë të UÇK-së kanë bërë të ditur se do të udhëtojnë drejt Hagës për të qenë pranë ish-krerëve të UÇK-së në ditët kur pritet shpallja e aktgjykimit.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi ndodhen në paraburgim në Hagë që prej nëntorit të vitit 2020. Ata akuzohen nga Prokuroria Speciale për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuza të cilat janë mohuar nga të pandehurit dhe ekipet e tyre mbrojtëse.

Procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023. Gjatë deklarimeve të tyre para trupit gjykues, ish-krerët e UÇK-së kanë mohuar akuzat dhe kanë mbrojtur luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke theksuar se ajo ishte një luftë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Avokatët mbrojtës kanë kërkuar shpalljen e pafajësisë së katër të akuzuarve, duke kundërshtuar pretendimet e Prokurorisë dhe duke argumentuar se akuzat nuk mbështeten në prova të mjaftueshme.

#marshiperliri #UÇK


**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.



Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KOSOVA
**Kosova me Qeveri të re! Kuvendi miraton...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 17:49



KOSOVA
**Pas konstituimit të Kuvendit, Albin Kurti...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 15:26



KOSOVA
**Kuvendi i Kosovës konstituohet pa PDK...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 13:37


## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.